

|                                                                                                                                    |      |                                       |           |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|---------------------------------------|-----------|
| REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA<br>INSTITUTI I HISTORISE - INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA ISTORIJU |      |                                       |           |
| Mjesa Org.<br>Org. Udh.<br>Org. Jeto.                                                                                              | 1. H | Nr. I. prot.<br>Prot. N.<br>Br. Prot. | 01/191/14 |
| Nr. Faqeve<br>No. Pages<br>Br. Stranca                                                                                             | 3 fg | Data:<br>Datum:                       | 27/10/14  |
| PRISHTINE - A                                                                                                                      |      |                                       |           |



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TË SHQIPËRISË - TIRANË

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Palët pajtohen për bashkëpunim të ndërsjellë:

### Neni 1

#### Palët

1. Palët në këtë memorandum janë:

**Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë - Tiranë, dhe**

**Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë**

### Neni 2

#### Qëllimi dhe arsyetimi

1. Qëllimi i këtij memorandum lidhet me përpjekjet për thellimin dhe krijimin e raporteve reciproke institucionale në mes të palëve.
2. Palët për realizimin e qëllimit do të ndërmarrin hapa konkretë, duke realizuar edhe programe të veçanta.
3. Përfituesit e këtij memorandum janë palët nga pika 1.

### Neni 3

#### Fushëveprimi i bashkëpunimit të palëve

1. Palët pajtohen ta informojnë njëri - tjetrin për pasuritë arkivore në zotërim, që paraqesin interes të përbashkët, duke shkëmbyer kopje të udhërrëfyesve, katalogjeve dhe formave të tjera të evidencimit të tyre.
2. Palët pajtohen për shkëmbimin e pasurive arkivore, përkatësisht fondeve arkivore që u janë të nevojshme ndërsjellurazi (në formën e fotokopjeve, mikrofilmave, riprodhimeve në bartës elektronikë - CD, disketa etj.) si dhe të botimeve të tyre mbi bazën e barazisë.
3. Palët pajtohen që t'i bëjnë të ditur njëri - tjetrit përmbajtjen e dokumenteve kryesore që kanë në zotërim dhe që kanë karakter dhe interes për studim dhe hulumtim, në përputhje me kriterin e rëndësisë historike kombëtare.

4. Palët pajtohen që të mundësojnë kërkimin e lirë të specialistëve të tyre ose të studiuesve të autorizuar prej tyre, në fondet që trashëgojnë, duke respektuar aktet ligjore përkatëse. Shërbimi me fotokopje dhe me forma të tjera që ofrohet nga palët me tarifë të privilegjuar.

5. Palët pajtohen që ta informojnë njëri - tjetrin për çështje të cilat paraqesin interes të përbashkët në lëmin e veprimtarisë shkencore - kërkimore.

6. Palët pajtohen të bëjnë punë të përbashkët për botimin e dokumenteve, veprimtarive shkencore - kërkimore etj., duke u mbështetur në kontrata të veçanta për secilin projekt veç e veç.

7. Palët pajtohen të bashkëpunojnë në veprimtarinë shkencore - kërkimore, në kuadrin e nismave rajonale, ballkanike, evropiane dhe botërore.

8. Palët për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartojnë programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve të tyre.

9. Për ta ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara me këtë Memorandum, përfaqësues të të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohet me korrespondencë.

#### **Neni 4**

##### **Autorizimet**

1. Palët garantojnë që bashkëpunimi të implementohet në pajtim me këtë memorandum.
2. Asnjëra nga palët nuk ngarkohen me obligime të veçanta përveç atyre që përcaktohen në këtë memorandum.

#### **Neni 5**

##### **Mosmarrëveshjet**

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me këtë memorandum, do të zgjidhet përmes negociatave.

#### **Neni 6**

##### **Anulimi**

1. Anulimi i këtij memorandum mund të bëhet me vullnetin e palëve, në rast se njëra prej tyre ka dështuar ta përmbushë atë.
2. Pala që dëshiron anulimin është e obliguar që të njoftojë palën tjetër, të paktën një muaj më parë.

#### **Neni 7**

### **Gjuha**

1. Gjuha e përdorur në këtë memorandum është gjuha shqipe.

### **Neni 8**

#### **Kohëzgjatja**

1. Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Kohëzgjatja e këtij memorandum është 4 (katër) vite.


### **Neni 9**

#### **Numri i kopjeve**

1. Ky Memorandum është hartuar në 4 (katër) kopje, nga dy për secilën palë nënshkruese.

### **PALËT NËNSHKRUESE**

**Instituti i Historisë "Ali Hadri"- Prishtinë**  
**Prof. assoc. dr. Sahit Sylja - Drejtor**



**Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë - Tiranë**  
**Gjet Ndoj - Drejtor**



**Tiranë, më 24.10.2014**